

BELBËZIMI DHE AFTËSITË KOGNITIVE¹

1. HYRJE

1.1. BELBEZIMI DHE AFTESITE KOGNITIVE : STUDIMET E DERITASHME

Ekziston mendimi në praktikë që personat të cilët belbëzojnë i takojnë grupit të njerëzve më të aftë intelektualisht, e belbëzimi është pikërisht manifestimi i disharmonisë ndërmjet mendimit të shpejtë dhe koordinimit të mendimeve në shprehje verbale. Stein (1942, në Beech dhe Fransella, 1968) thotë se lehtë është të vërehet që personat të cilët belbëzojnë kanë »imagjinatë të bujshme« gjë që rezulton në konflikt ndërmjet ideve dhe verbalizimit. Në favor të kësaj shkojnë edhe rezultatet e disa hulumtimeve. Frewald (1936, në Sheehan, 1970) ka konstatuar që grupi i subjekteve që belbëzojnë (N = 190 studentë) ka arritur rezultate më të mira në krahasim me grupin e 100 »brucoshëve« me të folur normal. Autori sugjeron mendimin, të cilin e ka theksuar Travis (1931, në Sheehan, 1970), që rezultatet janë pasojë e kampionit të seleksionuar të subjekteve që belbëzojnë, d.m.th. më pak e besueshme është të pritët që personi i cili belbëzon të regjistrohet në studime nëse nuk ka aftësi përkatëse intelektuale, me të cilat, në një farë mënyre, do ta kompensonte hendikepin verbal. Travis (1959, në Beech dhe Fransella, 1968) në kampionin prej 73 fëmijësh që kanë belbëzuar ka konstatuar rezultate dukshëm më të mira në krahasim me rezultatet e fëmijëve të grupit kontrollues.

Përkundër këtyre rezultateve dhe mendimeve, ekzistojnë studime në të cilat pohohet që personat të cilët belbëzojnë janë më inferiorë në aftësitë intelektuale në krahasim me popullatën e përgjithshme. Andrews dhe Harris (1964, në Beech dhe Fransella, 1968), me ndihmën e WISC-ut kanë studiuar dy grupe me nga 80 fëmijë, të cilët janë dalluar vetëm në rrjedhshmërinë e komunikimit verbal. Grupi kontrollues i subjekteve ka arritur rezultate më të mëdha shprehur nëpërmjet mesatares aritmetikore. Grupi eksperimental ka arritur rezultatin prej (QI = 94,7), ndërsa grupi kontrollues ka pasur vlerën mesatare (QI — 101,8). Autorët pohojnë se, përveq dallimeve numerike, nuk janë konstatuar edhe dallime të dukshme statistikore.

Ekzistojnë studime të cilat kanë dëshmuar që fëmijët të cilët arrijnë rezultate më të dobëta në suksesin shkollor. Conradi (1912, në Williams etj., 1969), ka konstatuar se fëmijët që kanë belbëzuar vonohen për sa i përket suksesit shkollor gjysmë viti në krahasim me grupin kontrollues të nxënësve. McDowell (1928, në Williams etj., 1969) po ashtu ka konstatuar se fëmijët të cilët belbëzojnë arrijnë rezultate dukshëm më të dobëta në shkollë në krahasim me grupin kontrollues të fëmijëve. Travis (1931, në Sheehan, 1970) ka vërtetuar rezultatet e McDowellit. DuPont (1946, në Williams, 1969) në kampionin prej 126 fëmijësh që kanë belbëzuar ka zbatuar testet për matjen e njohurive dhe shkathtësive shkollore dhe ka konstatuar që rezultatet e tyre janë nën normat testuese.

Numri më i madh i studiuesve pohojnë që nuk ekzistojnë dallime ndërmjet personave që belbëzojnë dhe personave që nuk belbëzojnë në aftësitë intelektuale, e rezultatet diç më të dobëta në suksesin shkollor i shpjegojnë me vështirësitë në procesin verbal dhe në rrethanat që në shkollë njohuritë arrihen dhe verifikohen kryesisht nëpërmjet komunikimit verbal.

¹ Ky punim është nxjerre nga libri :

Behlul Brestovci : **BELBEZIMI : Te folurit, inteligjenca antropometria, motorika, anksoziteti.**

LSHDK, Prishtine, 1988 (monografi shkencore, 304 f)

Kështu McDowell (1928, në Beech dhe Fransella, 1968), duke e zbatuar testin e inteligjencës të Stanford - Bineut, ka konstatuar se ndërmjet nxënësve që belbëzojnë dhe grupit kontrollues të nxënësve nuk ka dallime të dukshme. Carlson (1946, në Sheehan, 1975) me ndihmën e testit të njëjtë ka testuar 50 fëmijë të cilët kanë belbëzuar dhe 50 fëmijë me probleme emocionale. Grupi i subjekteve që kanë belbëzuar ka arritur rezultat mesatar prej (QI = 109), e rezultati është shtrirë ndërmjet 80 deri 130. Dallimet ndërmjet grupeve nuk janë konstatuar. Darley (1955, në Sheehan, 1970) në grupin prej 50 fëmijësh që kanë belbëzuar ka zbatuar testin e reviduar të Stanford - Bineut dhe WISC-un. Duke krahasuar rezultatet me normat e popullatës së përgjithshme, nuk ka konstatuar asfarë dallimesh. Johnson (1955) ka studiuar grupin e fëmijëve (N = 50) të cilët kanë belbëzuar dhe nuk ka vërejtur dallime të dukshme në krahasim me rezultatet e inteligjencës së popullatës së përgjithshme.

Përveç hulumtimit të dallimeve në aftësitë intelektuale, posaçërisht është i rëndësishëm studimi i raporteve ndërmjet aftësive kognitive dhe manifestimeve të belbëzimit. Kjo lidhje, mjerisht, është studiuar shumë pak. Sa na është e njohur, këtë problem në mënyrë eksplicite e ka studiuar vetëm një autor. Davis (1940, në Beech dhe Fransella, 1968) në kampionin prej 62 fëmijësh të moshës parashkollore ka gjetur korrelacione të dukshme ndërmjet përsëritjes dhe QI.

Ekzistojnë edhe studime të cilat në mënyrë indirekte janë përpjekur të lidhin belbëzimin me aftësitë intelektuale, duke e studiuar këtë çrregullim të të folurit te subjektet e retarduarë mentalisht. Kështu Wahl (1951, në Beech e Fransella, 1968) ka vërtetuar hipotezën që te fëmijët e retarduar mentalisht ekziston tendencë më e fuqishme për manifestimin e simptomave të belbëzimit. Më këtë autori ka dashur të vejë në lidhje belbëzimin dhe aftësitë intelektuale.

Në fund të kësaj pasqyre të shkurtër të studimeve duhet përkujtuar që kampioni i subjekteve të këtyre studimeve kryesisht është i pakët dhe heterogjen për nga mosha e subjekteve, prandaj është vështirë të nxirret përfundim i caktuar për aftësitë intelektuale të personave që belbëzojnë, e edhe më pak për raportet ndërmjet aftësive intelektuale dhe fenomenologjisë së belbëzimit.

2. QELLIMI I HULUMTIMIT

Inteligjenca apo me saktë me thënë, aftësitë kognitive, shumë shpesh janë lidhur me belbëzimin si dukuri, si jorrijedhshmëri e të folurit të njeriut. Opinonet dhe qëndrimet e hulumtuesëve të kësaj dukurie janë të ndryshme. Derisa disa mendojnë se belbëzimi ndërlidhet me “imagjinatën e bujshme” të disa fëmijëve në periudhën e zhvillimit të të folurit, kur mekanizmat e tij ende nuk janë të përpunuar sa duhet, ka edhe të tillë që mendojnë se fëmijët që belbëzojnë janë më inteligjent se fëmijët pa këtë vështirësi. Edhe studimet eksperimentale nuk kanë dhënë rezultate definitive për këtë problematikë.

Njëhërit shtrohet çështja e ndërlidhjeve në mes të llojeve të jorrijedhshmërive (gabimeve) në të folur dhe aftësive kognitive. Derisa dallimet në inteligjencë ndërmjet individëve që belbëzojnë dhe atyre me të folur standard, kane qenë objekt i hulumtimit të shumë autorëve, raportet e “gabimeve” në të folur me hapsirën kognitive shumë pak janë studiuar.

Në këtë punim dy janë qëllimet kryesore si mundësi përgjigjeje në dy pyetje kërkimore:

/1/ a dallojnë adoleshentët pesëmbëdhjetëvjeçare të cilët belbëzojnë nga moshatarët e

tyre me të folur të rrjedhshëm në hapsirën kognitive?

/2/ çfare janë ndërlidhjet e “gabimeve” në të folur (nëntë variabla) me variablat e aftësive kognitive (11 variabla)

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në këtë studim janë shtruar dy hipoteza themelore:

H1: *Kampioni i subjekteve që belbëzojnë nuk dallohet nga kampioni i subjekteve që nuk belbëzojnë në variablat manifestuese të dedikuara për përcaktimin e aftësive kognitive.*

Ekzistojnë studime të shumta për aftësitë kognitive të personave që belbëzojnë. Mjerisht, asnjë studim në këtë fushë nuk është bërë brenda vendin. Në pasqyrën e studimeve të aftësive kognitive (HYRJA) janë paraqitur mendime të autorëve të ndryshëm nga bota për këtë problematikë. Shumë studiues pohojnë se nuk ekzistojnë dallime ndërmjet personave që belbëzojnë dhe personave që nuk belbëzojnë. Konsiderojmë se mendimi i tillë i përgjigjet realitetit, për ç'arsye edhe është dhënë hipoteza e përmendur.

H2: *Nuk ekziston lidhje e rëndësishme ndërmjet variablave dedikuara përcaktimit të belbëzimit dhe variablave kognitive manifestuese.*

Aspektet motorike, të cilat te personat që belbëzojnë nganjëherë janë në disharmoni në procesin e komunikimit verbal-tingullor, nuk kanë mekanizma të njëjtë të funksionimit me aftësitë kognitive. Belbëzimi nuk godet vetëm një grup të caktuar të personave në raport me aftësitë kognitive. Belbëzimi është i përhapur ndër të gjitha grupet e folësve, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të aftësive kognitive.

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1. SUBJEKTET

Të folurit e personave që belbëzojnë, si formë jostandarde e të folurit, është manifestim më i hetueshëm i cili këta persona i klasifikon në grup të posaçëm të folësve. Ndonëse të folurit e tyre njihet lehtë si jostabil, me ndërprerje dhe »i rëndë« për folësin dhe bashkëbiseduesin, studimet kanë dëshmuar se ekzistojnë forma tejet të nuancuara të belbëzimit, të cilat vetëm me analizë profesionale mund të provohen (Johnson, 1959, 1961; Froeschels, 1964).

Të folurit e subjekteve për këtë studim klinikisht është provuar para fillimit të hulumtimit, e më vonë hollësisht është analizuar për të vlerësuar saktësisht të folurit jostandard. Përveç kësaj, për klasifikimin e subjekteve në grupin e personave që belbëzojnë, janë shfrytëzuar edhe informatat e arsimtarëve të gjuhës amtare dhe mendimet e vetë subjekteve për të folurit vetjak.

Studimi është bërë në kampionët e popullatës së nxënësve që belbëzojnë dhe nxënësve që nuk belbëzojnë, të gjinisë mashkullore, me moshë katërmbëdhjetë e gjysmë deri pesëmbëdhjetë – vjeçare e gjysmë. Vetëm variabla »BELBËZIMI« është marrë si kriter i zgjedhjes së subjekteve në njërin nga këta dy kampionë. Të gjitha karakteristikat e tjera psikosomatike kanë ndërruar rastësisht.

Zgjedhja e subjekteve të gjinisë mashkullore me moshë pesëmbëdhjetëvjeçare është bërë për këto shkaqe:

1) Belbëzimi është i përhapur dukshëm më tepër ndër persona të gjinisë mashkullore; më së shpeshti paraqiten rezultatet që në katër persona të gjinisë mashkullore, belbëzon vetëm një femër, e ka studime në të cilat proporcioni del edhe më i lartë; shkaku i dytë është i natyrës financiare, përfshirja e subjekteve të gjinisë femërore do të kishte dyfishuar shpenzimet materiale të studimit, po edhe për sa i përket aspektit kohor kjo do të kishte qenë shumë vështirë, meqë të gjitha hulumtimet janë bërë në lokalet e shkollave në të cilat kanë ndjekur mësimet subjektet.

2) Meqë qëllimi themelor i këtij studimi është përcaktimi i raportit ndërmjet belbëzimit dhe aftësive kognitive, është konsideruar që subjektet e moshës 15-vjeçare kanë pas vetes

periudhë bukur të gjatë të zhvillimit të belbëzimit, të aftësive motorike dhe dimensioneve kognitive, prandaj me saktësi më të madhe mund të përcaktohen raportet e tyre; ndërsa subjektet me të folur standard të kësaj moshe plotësisht kanë automatizuar të folurit dhe mundësia për të filluar të belbëzojnë është minimale.

3) Popullata e pesëmbëdhjetëvjeçarëve është përfshirë në shkollim të rregullt, e kjo ka bërë të mundshme të zgjidhen më lehtë subjektet dhe më lehtë të kryhet hulumtimi.

4.1.1. KAMPIONI NGA POPULLATA E NXËNËSVE QË BELBËZOJNË

Kampioni i subjekteve është zgjedhur ashtu që të jetë reprezentativ për popullatën e nxënësve që belbëzojnë, vijuesit e shkollave të rregullta të fazës së parë dhe të dytë të R. e Kroacisë. Për këtë studim janë zgjedhur vijuesit e shkollave të rregullta të fazës së parë dhe të dytë të Zagrebit, Rijekës, Splitit dhe të Karlovcit. Në këtë studim është përfshirë vetëm popullata e pesëmbëdhjetëvjeçarëve të qytetit, meqë numri më i madh i shkollave është i koncentruar në qytete, kështu që në mënyrë më të suksesshme dhe më ekonomike ka qenë e mundshme të kryhet hulumtimi. Në anën tjetër, popullata e nxënësve të qytetit me probabilitet të madh mund të jetë reprezentues për tërë republikën duke pasur parasysh lëvizjet migruese në shoqëri.

4.1.1.1. Definimi i popullatës së pesëmbëdhjetëvjeçarëve që belbëzojnë

Popullata e pesëmbëdhjetëvjeçarëve që belbëzojnë është definuar ashtu që secili subjekt nga kjo popullatë duhet të përmbushë këto kritere:

- 1) nxënësi duhet të jetë në moshën katërmëdhjetë e gjysmë deri pesëmbëdhjetëvjeç e gjysmë,
- 2) nxënësi duhet të jetë i gjinisë mashkullore,
- 3) nxënësi duhet të vijojë rregullisht shkollën e fazës së parë ose të dytë në njërin nga qytetet: Zagreb, Rijekë, Split, Karlovc,
- 4) nxënësi nuk bën të ketë sëmundje somatike ose kronike të çfarëdo lloji, të cilat e pengojnë të merret me aktivitete kineziologjike dhe
- 5) nxënësi duhet të ketë vështirësi në të folur të cilat klasifikohen si belbëzim.

4.1.1.2. Kampioni i pesëmbëdhjetëvjeçarëve që belbëzojnë

Për nxjerrjen e kampionit të subjekteve janë anketuar 222 shkolla të fazës së parë ose të dytë në qytetet: Zagreb, Rijekë, Split dhe Karlovc në mënyrë që të ndahen vijuesit e shkollave për të cilët arsimtarët e gjuhës amtare konsiderojnë se belbëzojnë, e të cilët përmbushin kërkesat e zgjedhjes së kampionit.

Pas analizës së bërë të të folurit të të gjithë nxënësve, emrat e të cilëve i kemi nxjerrë nëpërmjet anketimit, është bërë kampioni prej 127 pesëmbëdhjetëvjeçarësh, të cilët kanë plotësuar të gjitha kushtet e parashtruara. Kampioni i subjekteve për këtë studim përfundimisht është përbërë nga 107 nxënës si vijon:

- 59 subjekte kanë ndjekur shkollën e rregullt në Zagreb,
- 19 subjekte kanë ndjekur shkollën e rregullt në Rijekë,
- 15 subjekte kanë ndjekur shkollën e rregullt në Split,
- 14 subjekte kanë ndjekur shkollën e rregullt në Karlovc.

Duke pasur parasysh mënyrën e zgjedhjes dhe numrin e kampionëve si dhe qëllimet e këtij studimi, konsiderojmë që ky kampion i subjekteve është reprezentativ për popullatën hipotetike të definuar si popullatë pesëmbëdhjetëvjeçarësh, vijues të shkollës së rregullt në qytetet e R. e Kroacisë të cilët kanë aso vështirësish në të folur që mund të klasifikohen si belbëzim.

4.1.2. KAMPIONI NGA POPULLATA E NXËNËSVE QË NUK BELBËZOJNË

Njëri nga qëllimet e studimit ka qenë edhe përcaktimi i dallimeve ndërmjet personave që belbëzojnë dhe personave që nuk belbëzojnë në dimensionet kognitive. Për t'u arritur ky qëllim është dashur të definohet popullata e subjekteve që nuk belbëzojnë dhe të zgjidhet kampioni i subjekteve.

Popullata e nxënësve që nuk belbëzojnë është definuar me kritere të njëjta sikurse edhe popullata e nxënësve që belbëzojnë, përveç kriterit të pestë, i cili thoshte:

- nxënësi nuk bën të ketë aso vështirësish në të folur të cilat mund të klasifikohen si belbëzim.

Nga popullata e definuar kështu, me metodën e zgjedhjes së rastësishme në kampion të subjekteve për përcaktimin e hapësirës kognitive janë zgjedhur 291 subjektë:

- 173 subjekte nga shkolla e rregullt e Zagrebit,
- 52 subjekte nga shkolla e rregullt e Rijekës,
- 32 subjekte nga shkolla e rregullt e Splitit,
- 34 subjekte nga shkolla e rregullt e Karlovci.

Në kampion të subjekteve për përcaktimin e dallimeve në dimensionet kognitive janë zgjedhur 102 subjekte:

- 62 subjekte vijues të shkollës së rregullt në Zagreb,
- 15 subjekte vijues të shkollës së rregullt në Rijekë,
- 13 subjekte vijues të shkollës së rregullt në Split dhe
- 12 subjekte vijues të shkollës së rregullt në Karlovc.

4.2. INSTRUMENTET MATËSE

Vlerësimi i duhur i raporteve ndërmjet belbëzimit dhe aftësive kognitive, si problem themelor që është shtruar në qëllimet dhe hipotezat e këtij studimi, nënkupton definimin e mirë të çdo hapësire veç e veç, si dhe zgjedhjen e mostrave të instrumenteve matëse, të cilat mund të reprezentojnë ato hapësira. Instrumentet për tubimin e informatave që janë përdorur në këtë studim janë zgjedhur nga këto fusha shkencore:

- *instrumente nga fusha e logopedisë*: komunikimi jostandard verbal-tingullor me intencë që të masin intensitetin e belbëzimit,
- *instrumente psikologjike* nga fusha e dimensioneve kognitive.

4.2.1. KAMPION VARIABLASH PËR PËRCAKTIMIN E BELBËZIMIT

Belbëzimi si çrregullim i theksuar i rrjedhshmërisë së komunikimit verbal paraqet një sindrom manifestimesh të shumta. Studimet e deritashme dëshmojnë për mundësinë e matjes dhe përcaktimit të strukturës së tij manifestuese nëpërmjet metodave dhe mënyrave të disiplinave të ndryshme shkencore. Megjithatë, metodat më të rëndësishme të përshkrimit, definimit dhe të përcaktimit të belbëzimit i takojnë logopedisë, e cila merret me zgjidhjet teorike dhe praktike të vështirësive në komunikimin verbal.

Përkundër faktit që kjo disiplinë shkencore ka filluar të zhvillohet vetëm në vitet tridhjetë të shekullit njëzet, nevoja dhe rëndësia që i jepen komunikimit verbal kanë mundësuar zhvillimin e shpejtë dhe efikas të metodave dhe mënyrave të posaçme si për diagnostifikimin, ashtu edhe për sanimin e një numri të madh të dëmtimeve të të folurit. Belbëzimi, për shkak të modaliteteve, specifike dhe tejet të theksuara të sjelljes verbale, zë vend qendror në logopedi. Ndonëse belbëzimi nuk është çrregullim më i shpeshtë, megjithatë ekziston mundësia e paraqitjes së këtij çrregullimi të të folurit te një numër i madh fëmijësh. Numri absolut i personave që kanë këtë çrregullim është tejet i rëndësishëm, posaçërisht në

moshën e fëmijërisë, kur është vështirë të parashihet se te cilët fëmijë është i përkohshëm, e te të cilët do të bëhet kronik.² Me rëndësi të posaçme është të theksohet paraqitja e belbëzimit në moshën e hershme të fëmijërisë, kur sistemi folës ka rol të rëndësishëm në zhvillimin edhe të funksioneve, aftësive e shprehive të tjera. (Vigotski, 1962; Luria, 1961, Bikov, 1965).

Zhvillimi i metodave të posaçme të diagnostikës logopedike është intensifikuar edhe me arritjet bashkëkohore në fushë të regjistrimit dhe të analizimit të sinjaleve vizuale e akustike të komunikimit verbal.

Për përcaktimin e nënhapësirës së sjelljes verbale-tingullore të subjekteve që belbëzojnë janë zgjedhur këto variabla:

- INTENSITETI I BELBËZIMIT — i vlerësuar nga dhjetë vlerësues,
- KOHËZGJATJA E EMISIONIT TË TË FOLURIT dhe
- GABIMET NË TË FOLUR.

INTENSITETI I BELBËZIMIT: Mbi bazë të rezultateve të studimeve të autorëve të huaj dhe studimeve vetjake (Brestovci, 1975, 1976), është vendosur që intensiteti i belbëzimit të definohet si vlerësim i të folurit jostandard të personave që belbëzojnë prej dhjetë vlerësuesish. Vlerësues ishin studentët e vitit të katërt të logopedisë të cilët në ligjërata, ushtrime, seminare dhe në praktikë profesionale kanë arritur njohuri të mjaftueshme që të mund të vlerësojnë si duhet intensitetin e belbëzimit. Detyrë e vlerësuesve ishte të vlerësonin intensitetin e belbëzimit mbi bazë të dëgjimit të regjistrimit në magnetofon të leximit të secilit subjekt. Subjektet kanë lexuar tekstin nga romani i Mate Lovrakut («Dritarja pranë kopshtit»), i cili përmbante 274 fjalë. Vlerësuesit notat i shënonin në shkallën ordinare të notave prej 1 deri në 5: nota një ishte vlerësuese e belbëzimit me të dobët; e nota pesë e belbëzimit me të forte. Në këtë mënyrë janë nxjerrë 10 nota subjektive për belbëzimin e secilit subjekt. Meqë vlerat në shkallën ordinare nuk janë numra realë, sepse distanca e tyre nuk është definuar në mënyrë ekzakte dhe nuk është e barabartë për të gjitha vlerat në shkallë, notat e vlerësuesve u transformuan në T- score, të cilat paraqesin vlerat e tyre mediale në shkallën normale. Dhjetë brutovariablat e intensitetit të belbëzimit të fituara në këtë mënyrë, janë kondensuar me ndihmën e metodës së komponentit të parë kryesor në një variabël, që përmban sasinë më të madhe të mundshme të informatave të të gjithë vlerësuesve.

KOHËZGJATJA E EMISIONIT TË TË FOLURIT: Për këtë studim kohëzgjatja e emisionit të të folurit është definuar si shpejtësi e leximit të listës së fjalëve nga testi i Furlanit të leximit të zëshëm (Furlan, 1963). Me këtë metodë është barazuar sasia e materialit për lexim për të gjithë subjektet (janë lexuar vetëm 60 fjalë të testit) dhe është matur koha e leximit me sekonda. Leximi është marrë si masë më e sigurt e shpejtësisë së të folurit në krahasim me të folurit spontan.

² Van Riper (1971), duke rezytuar pasqyrën e hulumtimeve të ndryshme për dendurinë e belbëzimit, paraqet që deri në moshën trevjeçare në formë kronike belbëzojnë 0,55% të fëmijëve, deri në moshën tetëvjeçare kjo përqindje arrin maksimumin prej 1,6%, ndërsa në moshën 12-vjeçe stabilizohet sikurse te të rriturit në 1,1%. Cituar sipas autorit të njëjtë, Seeman (1959) përmend vetëm 0,55% të fëmijëve që belbëzojnë nga 26.000 fëmijë të moshës shkollore në Pragë; Ozana (1960) në kampion prej 146.000 fëmijësh të moshës shkollore në Japoni ka gjetur 0,82% të fëmijëve që belbëzojnë; McAllirter (1977) ka gjetur 1,0% në kampion prej 21.000 fëmijësh të moshës shkollore në Angli; Petkov e Josipov (1960) përmendin 1,7% të fëmijëve nga 45.000 të testuar në Bullgari; Rezultate të ngjashme ka edhe Aron (1962) duke analizuar fëmijët e moshës shkollore të Afrikës (N=6.500, 1,26%). Në një kampion të vogël prej 578 nxënësish të shkollës fillore janë gjetur 1,9% të fëmijëve që belbëzojnë (Brestovci etj., 1972).

GABIMET NË TË FOLUR: Për këtë studim gabimet në të folur të personave që belbëzojnë është janë përcaktuar këto nëntë lloje gabimesh:

Lloji i gabimit	Shifra
1. Përsëritja e pjesëve të fjalëve	RROKJE
2. Përsëritja e fjalëve	FJALA
3. Përsëritja e frazave	FRAZA
4. Zgjatja e tingujve	ZGJAT
5. Ndërfutje të ndryshme	NDËR
6. Pauzat e shkurtëra e të gjata	PAUZAT
7. Ndryshimi i shpejtësisë së leximit	TEMPO
8. Theksi joadekuat i fjalisë	RITMI
9. Mungesa të ndryshme	MUNG

Këto gabime janë nxjerrë nëpërmjet analizës së regjistrimit në magnetofon të leximit të tekstit prej 274 fjalësh (fragment nga romani i Mate Lovrakut »Dritarja pranë kopshtit«). Çdo gabim paraqet variabël të posaçme.

4.2.3. KAMPION VARIABLASH PËR PËRCAKTIMIN E AFTESIVE KOGNITIVE

Për përcaktimin e aftësive kognitive të subjekteve të të dy grupeve janë përdorur gjashtë instrumente matëse, karakteristikat metrike të të cilave janë provuar në popullatën e subjekteve të vendit dhe janë shënuar në librin »Evaluimi i metodave diagnostike« (Momiroviq i Kovaçeviq, 1970).

Testi i elokuencës — W_1 (modifikimi i testit të Thurstonit të elokuencës nga seria PMA): Ky test është i dedikuar për matjen e elokuencës së subjektit, d.m.th. sipas specifikimit të Thurstonit testi do të duhej të matte aftësinë për t'u menduar shpejt për fjalët e dhëna. Detyrë e subjektit në këtë test është që t'i thotë të gjitha fjalët që ekzistojnë në gjuhë, e të cilat fillojnë me shkronjën e parë të njëjtë që është dhënë. Testi përmban dy detyra, ndërsa koha e punës është e kufizuar. Ndonëse verifikimet empirike të këtij testi kanë dëshmuar që ky nuk është aq i përshtatshëm për vlerësimin e inteligjencës, rezultati i testit pasqyron mirë elokuencën e subjektit, prandaj edhe prej këtu faktori simbolik. Meqë rezultatet e testit nuk i nënshtrohen ndikimit të faktorit të neurotizimit, testi është i përshtatshëm për vlerësimin e elokuencës edhe te personat neurotikë.

Testi për emërtimin verbal të eliminimeve — EVE: (Momiroviq e Kovaçeviq) Detyrë e subjektit është që në vargun e dhënë të fjalëve të cilat me diçka ndër vete janë të ngjashme të gjejë fjalën e cila nuk i takon atij vargu. Testi ka 30 detyra të tilla me kohë të kufizuar për zgjidhje. Testi është i përshtatshëm për provimin e tipit verbal të inteligjencës. Ndërkaq, rezultatet lypset interpretuar me kujdes, kur është fjala për personat neurotikë.

Testi për emërtimin verbal të diferencave — EVD: (Momiroviq e Kovaçeviq); EVD po ashtu është test i thjeshtë verbal i inteligjencës, i përshtatshëm për vlerësimin e faktorit të përgjithshëm kognitiv. Përmban 30 detyra në të cilat nga subjekti kërkohet që ndër 5 fjalë të propozuara të gjejë atë që ka kuptim të kundërt në krahasim me atë të dhënë. Koha e punës në test është e kufizuar. Sikurse edhe te testi EVE, edhe në këtë test rezultatet janë më problematike sa më neurotik të jetë subjekti.

Testi për emërtimin verbal të sinonimeve - EVS (Momiroviq e Kovaçeviq): Edhe ky test është i dedikuar për matjen e inteligjencës verbale. Detyrë e subjektit është që ndër

pesë fjalët e propozuara të gjejë atë që ka kuptim të njëjtë ose tejet të ngjashëm me fjalën e dhënë. Ekzistojnë gjithsej 30 detyra të këtilla. Koha e zgjidhjes është e kufizuar. Analiza faktoriale e këtij testi (sikurse edhe te EVE e EVD) në hapësirën tridimensionale, të definuar me faktor kognitiv, faktorin e subordinimit dhe faktorin e neurotizimit, ka dhënë korrelacione të dukshme negative me faktorin e subordinimit dhe neurotizimit, gjë që bën të konkludohet se duhet kujdes i shtuar në interpretimin e rezultateve të personave neurotikë.

Matricat progresive — MP (J. C. Raven, 1938): Testi i matricave progresive përmban 60 detyra të ndara në 12 grupe me nga 12 detyra. Grupet e detyrave janë të konstruara mbi këto parime:

Grupi A — format kontinuele, Grupi B — analogjitë ndërmjet çifteve të figurave, Grupi C — alternimi progresiv i formës, Grupi D — permutacioni i figurave dhe Grupi E — analiza e figurave në pjesë përbërëse. Detyrë e subjektit është që ndër zgjidhjet e propozuara të zgjedhë pikërisht atë që plotëson matricën nga e cila një pjesë është lëshuar.

Testi Beta i reviduar — B₁ — B₆ (Kellog, Morton, Lindner dhe Gurvitz): Testi Beta përmban 6 subteste të cilat në këtë studim janë trajtuar si variabla të posaçme. Të gjitha gjashtë subtestet janë të tipit joverbal dhe zgjidhen në kohë të kufizuar.

B₁ - është testi i labirintit me intencë që të masë orientimin hapësinor. Përmban pesë detyra me peshë progresive.

B₂ - detyrë e subjektit është që në këtë subtest të substituojë simbolet me ndihmën e numrave. Testi do të duhej të matte shpejtësinë e transformimit të thjeshtë.

B₃ - testi i dedikohet matjes së aftësisë së subjektit për të përceptuar lidhjet dhe raportet ndërmjet situatave. Çdo detyrë përbëhet prej 4 fotografive, të cilat paraqesin situata të ngjashme, e njëra ndër të është absurde. Detyrë e subjektit është ta gjejë atë.

B₄ - është i dedikuar për matjen e rezonimit perceptual: Përbëhet prej 18 detyrash në të cilat nga subjekti kërkohet që katrorin e dhënë ta plotësojë drejt me segmente të propozuara. Për shkak të korrelacionit diç më të madh negativ me faktorin e neurotizimit, rezultatet e fituara në këtë test duhet të interpretohen më me kujdes te personat neurotikë.

B₅ - i dedikohet matjes së inadekuates perceptuale. Subtesti përmban 20 detyra prej të cilave secila paraqet një vizatim në të cilin mungon një detaj, ndërsa detyrë e subjektit është ta vizatojë detajin që mungon.

B₆ - është test i identifikimit. Subjekti duhet t'i shënojë me plus çiftet e vizatimeve ose të numrave të ndryshëm.

4.3 METODAT E PERPUNIMIT TE REZULTATEVE

Metodat e përpunimit të të dhënave janë përzgjedhur duke i patur parasysh qëllimet dhe hipotezat e shtruar në punim.

Për të gjitha variablat manifestuese janë llogaritur treguesit themelorë statistikorë, si dhe është testuar normaliteti i shpërndarjeve të tyre, me metodën Kolmogorov-Smirnov.

Meqenëse përgjigjet në hapsirën e vlerësimeve e 10 vlerësuesve gjatë vlerësimit të intensitetit të belbëzimit janë dhënë në shkallë ordinale prej pesë njësisish, është zbatuar mënyra e normalizimit të çdo vlerësuesi, para se këto rezultate të jenë përpunuar me metodat tjera. Pastaj me komponentin e pare janë kondezuar rezultatet e 10 vlerësuesëve në një rezultat të përbashkët.

Dallimet ndërmjet subjekteve që belbëzojnë dhe subjekteve që nuk belbëzojnë në hapësirën kognitive, janë konstatuar me analizën vecuese (diskriminative) kanonike dhe analizën njëfaktoriale të variancës.

Për përcaktimin e raporteve ndërmjet belbëzimit dhe ndikimit të aftësive kognitive në jorrijdhshmërit (gabimet) verbale të personave që belbëzojnë, janë zbatuar këto metoda : me analizë regresiste janë konstatuar ndikimet ndërmjet këtyre dy hapësirave, ndërsa me koeficientin e korrelacionit sipas Pearsonit janë konstatuar raportet bivariate ndërmjet 11 variablave të hapësirës kognitive dhe 9 variablave të gabimeve në të folur.

5. REZULTATET DHE INTERPRETIMI I TYRE

5.1. DALLIMET NË VARIABLAT KOGNITIVE NDËRMJET KAMPIONIT EKSPERIMENTAL DHE ATIJ KONTROLLUES

Për studimin e dallimeve ndërmjet grupeve të subjekteve janë zbatuar 11 variabla të hapësirës kognitive. Distribuiet e të gjitha variablave në të dy grupet e subjekteve nuk janë dalluar dukshëm nga ndarja normale e rezultateve. Për konstatimin e dallimeve janë zbatuar dy metoda: analiza kanonike e veçimit dhe analiza njëfaktoriale e variancës.

Koeficienti i analizës kanonike veçuese është (0.24), gjë që krahas shkallëve ekzistuese të lirisë statistikisht nuk është i vlefshëm. Me këtë mund të përfundohet që grupet e subjekteve nuk dallohen dukshëm në tërë hapësirën e variablave të zbatuara kognitive. Pasqyra tabelare e rezultateve të analizës veçuese nuk është paraqitur në punim.

Tabela nr. 1.

PARAMETRAT THEMELORË STATISTIKORË DHE ANALIZA E VARIANCËS SË VARIABLAVE KOGNITIVE PËR GRUPIN EKSPERIMENTAL DHE KONTROLLUES TË SUBJEKTEVE

Variabla	Grupi	eksperi- mentues	SIG1	Grupi	kontroll- ues	SIG2	F- përp	Q
	X1			X2				
WI	45.94	2.16	11.5	47.07	2.35	12.1	0.4667	0.4953
EVE	22.17	0.69	3.6	22.75	0.60	3.1	1.5600	0.2131
EVD	24.74	0.75	3.9	24.55	0.50	2.6	0.1757	0.6759
EVS	22.09	0.78	4.1	23.56	0.52	2.7	9.1489	0.0028
PM	44.26	1.62	8.5	46.00	1.75	9.0	2.0183	0.1569
B 1	8.74	0.22	1.2	8.76	0.25	1.3	0.0128	0.9099
B 2	22.53	0.70	3.7	22.95	0.70	3.6	0.6913	0.4067
B 3	11.43	0.56	2.9	11.79	0.56	2.9	0.7826	0.3774
B 4	10.63	0.70	3.6	11.67	0.71	3.6	0.1180	0.0437
B 5	10.08	0.50	2.6		0.49	2.5	0.7401	0.3906
B 6	18.76	0.55	2.9	18.64	0.54	2.8	0.1037	0.7478

$N_{eks} = 107$

X1 e **X2** mesataret aritmetikore te grupeve

F- F testi

$N_{kon} = 102$

SIG1 e **SIG2** devijimet standarde te grupeve

Q- sign e F testit

Nga tabela 1 mund të konstatohet se vetëm në variablën EVS (Testi për emërtimin e sinonimeve) F-testi statistikisht është i vlefshëm në nivel prej 0.01. Te të gjitha variablat e tjera F-përpjestimi është mbi kufirin e pranuar të vlerës. Duhet përmendur që në variablën B₄ F-përpjestimi i afrohet nivelit statistik të vlerës.

Rezultatet janë në harmoni me hipotezën e shtruar që ndërmjet subjekteve që belbëzojnë dhe subjekteve që nuk belbëzojnë nuk ekzistojnë dallime në aftësitë kognitive.

Këto rezultate shkojnë në favor të pohimeve të autorëve siç janë McDowell (1928), Carlson (1964), Johnson (1959) e të tjerë.

Nëse e përkujtojmë përshkrimin e variablave, ku është thënë që disa variabla të dedikuara për matjen e aftësive kognitive, u nënshtrohen simptomave neurotike, ndonëse na duket e logjikshme të supozohet që aty duhet kërkuar shpjegimin e dallimit të fituar. Analiza faktoriale e testeve EVS, EVD dhe EVE (Momiroviq e Kovaçeviq, 1970) në hapësirën tridimensionale të definuar me faktorin e përgjithshëm kognitiv, faktorin e subordinimit dhe faktorin e neurotizmit ka dëshmuar që këto teste kanë korrelacione të rëndësishme negative me faktorin e neurotizmit. Mund të supozohet që simptomat neurotike kanë ndikuar që subjektet që belbëzojnë të kenë rezultate diç më të dobëta, si grup, e variabilitet shumë më të madh, në krahasim me moshatarët e tyre. Hulumtimet e deritashme kanë dëshmuar që dimensionet patologjike konative ndikojnë negativisht në funksionimin e sistemit kognitiv. Po ashtu në një sërë studimesh është konstatuar që personat të cilët belbëzojnë manifestojnë më tepër simptomat '*neurotike*' në krahasim me subjektet me të folur normal. Kjo është konstatuar edhe në studimin tonë. Shpjegim i njëjtë mbase mund të jepet edhe për rezultatet në testin B4.

Nga vështrimi dhe krahasimi i mesatareve aritmetikore mund të konstatohet që ato dallohen vetëm për një pikë, porse për këtë devijimet standarde dallohen tejet shumë. Kjo do të thotë që Testi EVS më mirë i dallon subjektet që belbëzojnë, e njëherësh do të thotë që dispersioni i rezultatit në atë grup është nën ndikimin sistematik të ndonjë faktori. Dispersione më të mëdha të rezultatit rreth mesit aritmetikor mund të vërehen edhe te variablat EVD dhe EVE në grupin e subjekteve që belbëzojnë.

5.2. REZULTATET E VARIABLAVE PËR PERCAKTIMIN E BELBËZIMIT

Për t'u definuar sa më mirë hapësira e sjelljes verbale të subjekteve që belbëzojnë, për këtë hulumtim janë zgjedhur ato veprime e masa të cilat në logopedi konsiderohen efikase, objektive dhe të mira. Për përcaktimin e pamjes së përgjithshme të belbëzimit janë zbatuar disa mënyra rezultatet e të cilave janë kondensuar në tri dimensione: INTENSITETI I BELBËZIMIT, GABIMET NË TË FOLUR DHE KOHËZGJATJA E EMISIONIT TË TË FOLURIT.

Variablat e përmendura në këtë hulumtim kanë paraqitur sistemin e variablave prediktore.

5.2.1 Vlerësimi i intensitetit të belbëzimit

Rezultatet për vlerësimin e intensitetit të belbëzimit të secilit subjekt janë nxjerrë në bazë të vlerësimeve subjektive të 10 vlerësuesve, të cilët kanë pasur njohuri të mjaftueshme profesionale për këto lloje çrregullimesh të të folurit.

Analizën e pjesërishme dhe interpretimet e rezultateve, autori i këtij punimi i ka bërë në një studim të botuar me herët (Brestovci, 1975). Për këtë arsye këtu nuk shpjegohet në mënyrë të hollësishme tërë veprimi i kondensimit të vlerësimeve subjektive të vlerësuesve në variabël unike.

Detyrë e vlerësuesve ishte që në bazë të dëgjimit të regjistrimit magnetofonik të të folurit të subjektit të vlerësonin intensitetin e belbëzimit në shkallën ordinale prej pesë njësisish. Rezultatet e fituara në këtë mënyrë paraqesin vlerësimin subjektiv të vlerësuesve. Zbërthimi i vlerësimeve të vlerësuesve, sipas kategorive të shkallës, është paraqitur në tabelën nr. 1.1. në kolonën shenjën F. Meqë vlerat në shkallën e tillë nuk janë numra realë (sepse hapësira e tyre nuk është definuar saktësisht e as që është e barabartë për të gjitha njësitë e shkallës), notat e secilit vlerësues janë transformuar në vlerën T, që paraqesin vlerat e tyre mediale në shkallën normale me parametrat $X = 0$, dhe $DS = 1$. Për normalizimin e rezultateve të vlerësuesve ishte e

nevojshme llogaritja e frekuencave kumulative (FC), frekuencave kumulative relative (FCR) sipërfaqes që i përket çdo kategorie si dhe medjanës që paraqiste vlerat T për notat e caktuara. Për testimin e normalitetit të distribuimit të notave të vlerësuesve janë llogaritur frekuencat kumulative, si dhe dallimet ndërmjet frekuencave të fituara kumulative relative dhe atyre të pritura (D). Ndryshimi maksimal është krahasuar me madhësinë limite të testit të Kolmogorov - Smirnovit për testimin e vlerës së shmangies së distribuimeve nga shpërndarja normale.

Pas kontrollimit të Tabelës 2.1. mund të konstatohet se asnjë distribucion nuk shmanget dukshëm nga ndarja normale, sepse të gjitha dallimet ndërmjet frekuencave të pritura kumulative dhe atyre të fituar janë më të vogla se madhësia (.1576), e cila paraqet vlerë kritike.

Me analizën e rezultateve më të vogla dhe më të mëdha të distribuicionit të vlerësuesve mund të vërehet që ky rend është relativisht i vogël dhe sillet ndërmjet dy e gjysmë dhe tri sigma. Rezultatet e tilla edhe janë pritur duke pasur parasysh numrin e kategorive të shkallës. Këto rezultate me siguri do të ndikojnë edhe në hapësirën e variablës së kriterit.

Vlerat T të notave të vlerësuesve janë përdorur për llogaritjen e matricës së ndërkorrelacioneve të vlerësuesve, e cila është paraqitur në Tabelën 2.2. Koeficientet e korrelacioneve kanë madhësi të kënaqshme (prej .73 deri .87). Kjo është treguar edhe në madhësinë e unikuitetit të vlerësuesve (Tabela nr. 2.3.), që sillen prej (.1392; 8 vlerësues) deri (.2325; 2 vlerësues).

Me zgjidhjen e ekuacioneve karakteristike të matricës së ndërkorrelacionit është treguar që vetëm rreënja e parë sjellë informata të vlefshme, e njëherësh shpjegon përafërsisht të njëjtën sasi të variancës së përbashkët të sistemit (82,88%). Kjo e dhënë dëshmon se të gjithë vlerësuesit me 83% të variabilitetit kanë matur objektin e njëjtë (intensitetin e belbëzimit), prandaj vetëm 17% të variabilitetit të tyre mund të konsiderohet variancë e gabimit. Pas llogaritjes së komponentit të parë dhe të vetëm kryesor, janë llogaritur edhe gjatësitë e vektorëve të çdo vlerësuesi në hapësirë të re. Me analizën e Tabelës 2.6. mund të konstatohet që madhësitë e komunalitetit të dy vlerësuesve janë nën (.80). Se vlerësuesit kanë qenë vlerësues të mirë, mund të shihet me analizën e projeksioneve ortogonale të vektorit të vlerësuesve në objektin e përbashkët të matjes (Tabela 2.5). Korrelacionet e fituara mund të trajtohen si të larta (prej .82 deri .94).

Shumëzimi i vektorit të komponentit kryesor me matricë vlerave T ka dhënë rezultatet e subjekteve në variablën unike, e cila paraqet intensitetin e belbëzimit.

Variabla e fituar me kombinimin linear të dhjetë notave të vlerësuesve, teoritikisht duhet të përmbajë sasinë maksimale të informatave për intensitetin e belbëzimit të çdo subjekti, proporcionalisht me cilësinë e çdo vlerësuesi dhe në mënyrë optimale t'i diferencojë subjektet.

Këto supozime janë sëndërtuar edhe praktikisht, nëse analizojmë distribuicionin e kësaj variable në Tabelën nr. 2.7. Meqë rezultatet gjatë kondensimit janë normalizuar dhe standardizuar, mesatarja aritmetike e variablës është zero, e devijimi standard dhe varianca janë të barabarta me një. Distribuimi i rezultateve aproksimativisht është normal, duke i dalluar subjektet diç më mirë në zonën e rezultateve më të larta. Shtrirja e rezultateve sillet përbrenda 3.2 devijimeve standarde, gjë që paraqet variabilitetin real të belbëzimit të subjekteve.

Në fund mund të thuhet që kondensimi i dhjetë notave të vlerësuesve është bërë me sukses dhe që variabla e fituar do të reprezentojë si duhet një aspekt të manifestimit të sjelljes verbale të personave që belbëzojnë.

5.2.2. Gabimet në të folur

Manifestimet bazike të shprehjes verbale të personave që belbëzojnë janë gabimet e

shpeshhta (parrjëdhshmëritë, aritmitë) në të cilat bëjnë pjesë përsëritjet e ndryshme (pjesët e fjalëve, fjalët dhe frazat), të zgjaturit e tingujve, ndërputja e elementeve verbale dhe joverbale, pauza të shkurtëra dhe të gjata, ndërrimi i shpejtësisë së të folurit, theksi joadekuat i fjalisë, elidimi (lëshimi i pjesëve të fjalëve dhe frazave) e të tjera. Në fillim të belbëzimit vërehen vetëm gabimet e këtilla, ndërsa më vonë belbëzimit i bashkohen karakteristika të tjera të natyrës psikosociologjike dhe fiziologjike. Gabimet e karakterit verbal shumë rrallë eliminohen tërësisht në të folurit e personave të cilët belbëzimi merr formë kronike (Van Riper, 1972; Freund, 1972; Trotter, 1972; Agnello, 1972). Për këtë arsye, ato përbëjnë elementet themelore të strukturës manifestuese të shprehjes verbale. Përcaktimi dhe matja e tyre është pjesë e pandashme e diagnostikës dhe e suksesit në ndërmarrjen e rehabilitimit.

Matja e manifestimeve të tilla të belbëzimit është objektive, porse jo edhe e thjeshtë. Praktiki është e pamundshme të analizohen, të përcaktohen dhe të klasifikohen pa regjistrim magnetofonik ose magnetoskopik të sinjaleve verbale.

Në analizat e deritashme, si në praktikën shkencore ashtu edhe në praktikën klinike, intensiteti i belbëzimit në bazë të gabimeve në të folur është përcaktuar me mbledhjen e rëndomtë algjebrike të gabimeve në një rezultat, gjë që nga pikëpamja metodologjike nuk është gjithëherë korrekte. Në të vërtetë në një sërë hulumtimesh është vërtetuar (Young, 1961; Sander, 1961; Johnson, 1961), se të gjitha gabimet nuk kanë peshë të njëjtë në definimin e strukturës manifestuese të belbëzimit.

Autori i kësij studimi është përpjekur të analizojë tri herë gabimet e njëjta që janë zbatuar në këtë hulumtim, me qëllim që të caktohet struktura e gabimeve dhe të hetohet pesha dhe roli i llojit të caktuar të gabimeve në prediksonin e belbëzimit (Brestovci, 1977, 1976, 1977). Në hulumtimet e përmendura është dëshmuar se me zbatimin e mënyrave adekuate për përpunimin e rezultateve dukshëm, jo vetëm që mund të caktohet cilësia pragmatike e gabimeve në prediksonin e belbëzimit, por edhe struktura e tyre.

Në Tabelën nr.3.1 janë dhënë parametrat themelorë statistikor për çdo variabël të hapsirës së gabimeve në të folur. Gabimet janë llogaritur në tekstin e lexuar (prej 274 fjalësh). Në tabelën nr. 3.2. janë dhënë numerikisht dhe në përqindje llojet e gabimeve. Siqë shifet 107 individë të hulumtuar kane bërë gjithsejt 13 183 gabime. Numri më i madh i gabimeve në të folur përfshin *Ndërhyrjet e ndryshme* (23.35%) dhe Përsëritja e pjesëve të fjalëve (21.22%). Në tabelën nr. 3.3 janë paraqitur vlerat e koeficientëve të korrelacionit ndërmjet nëntë variablave të hapsirës së gabimeve. Shumica e koeficientëve janë statistikisht të vlefshëm dhe mesatarisht të lartë.

Tabela nr 3.2.

GABIMET NË TË FOLURIT E INDIVIDËVE QË BELBËZOJNË

	LLOJET E GABIMEVE	FREKUENCA	%
1	<i>Ndërhyrjet e ndryshme</i>	3 078	23.35
2.	<i>Përsëritja e pjesëve të fjalëve</i>	2 797	21.22
3.	<i>Ritmi joadekuat</i>	2 417	18.33
4.	<i>Pauzat e shkurtra e të gjata</i>	1 586	12.03
5.	<i>Përsëritja e fjalëve</i>	998	7.57
6.	<i>Të zgjaturit e tingujve</i>	710	5.39
7.	<i>Lëshimet e ndryshme</i>	691	5.24
8.	<i>Përsëritja e frazave</i>	512	3.88
9.	<i>Ndryshimi i tempit (shpejtësisë së leximit)</i>	394	2.99

GJITHSEJT : 13 183

N = 107 NXËNES TË MOSHËS 15-VJEÇARE -
(lexim i teksit të përbër nga 274 fjalë)

5.2.3. Kohëzgjatja e emisionit të të folurit

Kjo variabël mat një komponent specifik të gjenerimit dhe të transmetimit të sinjaleve të të folurit. Nga pikëpamja e teorisë së informatave dhe teorisë së sistemit, të cilat në mënyrë mjaft të suksesshme zbatohen në fushë të patologjisë së të folurit, efikasiteti i funksionimit të elementeve të caktuara si dhe i sistemit në tërësi, në rend të parë matet me saktësinë dhe shpejtësisë e transmetimit të informatave deri në cak. Komponenti i shpejtësisë është posaçërisht i rëndësishëm te ato sisteme të cilat informatat i dërgojnë në njësi të caktuara kohore. Sinjalet tingullore, si produkt themelor i mekanizmit folës në procesin e komunikimit verbal, për nga struktura e tyre në esencë i përkasin grupit të sinjaleve që janë të organizuara në rend të parë në kontinuumin e kohës. Këtu flitet vetëm për aspektin fizik të sinjaleve të të folurit, e jo edhe për përpunimin e tyre në sistemin nervor qendror. Njëra nga vështirësitë në matjen e shpejtësisë së sinjaleve të të folurit qëndron në faktin që praktikisht është shumë vështirë, e deri më sot ende nuk është arritur, të matet shpejtësia e të folurit dhe shpejtësia e transmetimit të sinjaleve ndaras. Në të folur rëndom këto dy aspekte të matjes gërshetohen (Minifie e Cooker, 1964; Cherry, 1971). Edhe kur përjashtojmë aspektin e »kuptimësisë« (p.sh. leximi me zë pa e ndjekur përmbajtjen) edhe më tej, krahas komponentit të transmetimit, mbetet edhe komponenti i gjenerimit të informacioneve motorike.

Përveç kësaj vështirësie, matja e kohëzgjatjes së emisionit të sinjaleve të të folurit është treguar e vlefshme në veprimin e përcaktimit të disa karakteristikave të efikasitetit të mekanizmit folës. Disa autorë konsiderojnë që kjo është masa më e mirë nga pikëpamja statistikore (Goldman - Eisler, 1964, 1967).

Tabela nr. 4.

DISTRIBUIMI I REZULTATEVE TË VARIABLAVE TË LOHËZGJATJES
SË EMISIONIT TË TË FOLURIT

XA = 57.5
DX = 4.094

SIG 2 = 466.56
SIG = 21.50

MIN = 29
MAX = 117

Klasa	Kufijtë	F	FC	FCR	FCT	D
1.	- 37	10	10	.0934	.1775	-.0841
2.	38 - 45	25	35	.3271	.2912	.0359
3.	46 - 53	25	60	.5607	.4285	.1322
4.	54 - 61	13	73	.6822	.5715	.1107
5.	62 - 69	14	87	.8131	.7088	.1043
6.	70 - 77	5	92	.8598	.8237	.0361
7.	78 - 85	3	95	.8878	.9002	-.0124
8.	86 - 93	2	97	.9065	.9523	-.0458
9.	94 - 101	2	99	.9252	.9785	-.0533
10.	102 - 109	3	102	.9533	.9920	-.0387
11.	110 - 117	5	107	1.0000	.9973	.0027

TEST = .1576
MAX D = .1322

Rezultatet e variablës së kohëzgjatjes së emisionit të të folurit janë paraqitur në Tabelën nr. 3. Nëpërmjet krahasimit të diferencës maksimale ndërmjet frekuencave relative të pritura dhe të fituara me madhësi të TESTIT, shihet që distribucioni i rezultateve nuk shmanget dukshëm nga ndarja normale, ndonëse skaji pozitiv i distribucionit është më shumë i lakuar. Shtrirja e rezultateve sillet në kufij të kënaqshëm prej katër devijimesh standarde. Ndonëse devijimi standard është relativisht i madh në krahasim me mesataren aritmetikore, e kjo është

shkaktuar për shkak të një numri të caktuar të subjekteve me rezultate të larta ekstreme, ky raport ende mund të tolerohet. Rezultati mesatar i grupit është tejte i lartë, sepse për shqiptimin e gjashtëdhjetë fjalëve mjaft të thjeshta është e nevojshme pothuajse një minutë e plotë (57.5 sec). Duke e krahasuar mesataren aritmetikore të subjekteve të këtij grupi me mesataren aritmetikore të moshatarëve³ të tyre që nuk belbëzojnë, mund të konstatohet vlerë pothuajse dy herë më e madhe në favor të të parëve. Rezultate të ngjashme në subjekte të njëjta në matjen e shpejtësisë së leximit të fragmenteve prej 274 fjalësh kanë konstatuar edhe Brestovci e Kërznar (1977). Dallime të mëdha dhe të rëndësishme ndërmjet grupeve të cilat dallohen vetëm në rrjedhshmërinë e të folurit janë konstatuar edhe në hulumtimet e Johnsonit e të tjerëve (1963), Youngut (1961), Sanderit (1961) etj. Për ilustrim të leximit shumë të ngadalshëm të subjekteve të këtij kampioni mund të paraqitet edhe fakti se nxënësit e klasës së katërt të shkollave fillore në testin e njëjtë, i cili është përdorur këtu, arrijnë rezultate të ngjashme me rezultatet e nxënësve që nuk belbëzojnë. Këtë fakt nuk duhet kuptuar sikur pesëmbëdhjetëvjeçarët që belbëzojnë nuk dinë të lexojnë, d.m.th. sikur ende nuk i kanë përvetësuar shprehitë e leximit deri në nivel të automatizimit, veçse që ata kanë vështirësi në formimin dhe/ose transmetimin e informatave motorike gjatë ekspresionit të tekstit të lexuar. Ndryshe, personat që belbëzojnë krejtësisht rrjedhshëm e lexojnë tekstin në heshtje duke e kuptuar tërësisht përmbajtjen e asaj që kanë lexuar.

5.3. RAPORTET NDËRMJET VARIABLAVE TË BELBËZIMIT DHE VARIABLAVE KOGNITIVE

5.3.1 Ndërkorrelacionet e dy grupeve të variablave

Nga Tabela nr. 5 lehtë bie në sy që numri më i madh i koeficienteve të korrelacionit është i parashenjës negative. Në këtë rast parashenja negative do të thotë kjo — sa më i mirë të jetë rezultati në teste të funksioneve kognitive, aq më i vogël është numri i gabimeve, ose aq më e shkurtër është koha e leximit dhe intensiteti i belbëzimit është më i vogël. Ndërkaq, koeficientet logjike negative të korrelacionit në këtë studim duhet të interpretohen si lidhje pozitive ndërmjet variablave kognitive dhe variablave të dedikuara për përcaktimin e belbëzimit. Korrelacionet statistikore negative janë shkaktuar ngaqë variablat e belbëzimit janë të kthyer në kahe të kundërta në krahasim me variablat e grupit të dytë, d.m.th. rezultati më i madh në variablat e belbëzimit do të thotë manifestime më të fuqishme të belbëzimit.

Karakteristikë e përgjithshme e matricës së korrelacioneve është se koeficientet janë kryesisht me parashenjë negative dhe me vlera të ulëta. Prej gjithsej 99 koeficientesh të korrelacioneve, vetëm 9 statistikisht janë të vlefshëm në nivel prej (0.01). Në nivel të vlefshmërisë prej (0.05) gjithsej janë 23 koeficientë, gjë që është një e katërta. Tri të katërtat nga numri i përgjithshëm i koeficientëve të ndërkorrelacionit praktikisht kanë vlerën zero.

Ndërlidhjen më të madhe me variablat kognitive e kanë realizuar variablat koha e zgjatjes së leximit (KOHA), ndërfutja (NDËRF), pauza të ndryshme (PAUZA), ndërrimi i theksit të fjalisë (RITMI) dhe variabla e vlerësimit të intensitetit të belbëzimit (VLER). Variablat përsëritja e fjalëve (FJALA) dhe përsëritja e pjesëve të fjalive (FRAZA) kanë koeficientë dukshëm më të ulëta (gjithsej tri karakteristika statistikore). Variablat përsëritja e pjesëve të fjalës (RROK) dhe të zgjaturit e tingujve (UGJAT), praktikisht kanë realizuar koeficiente zero me të gjitha variablat të hapësirës kognitive.

Struktura e tillë e lidhjes ndërmjet dy grupeve të variablave imponon interpretimin diferencial të disa grupeve të koeficienteve të ndërkorrelacionit. Nëse analizojmë lidhjet e variablave NDËRF, PAUZA, RITMI, KOHA mund të konstatojmë se ato në tërë matricën kanë

³ Rezultatet për grupin e subjekteve që nuk belebezojnë, nuk janë paraqitur, por ndodhen te autori i punimit

realizuar 18 koeficiente statistikore të vlefshëm prej gjithsej 24. Në qoftë se përpqimi hipotetikusht të interpretojmë këto lidhmëri në drejtim të varësisë së variablave të belbëzimit nga variablat kognitive, mund të themi që subjektet me rezultate më të mira në testet kognitive bëjnë gabime më të pakta, ose u nevojitet më pak kohë për lexim. Meqë variablat NDËRF, PAUZA dhe RITMI më së shpeshti »u ndihmojnë« personave që belbëzojnë për tejkalimin e formave më të rënda të belbëzimit, mund të thuhet që subjektet të cilët arrijnë rezultate më të mëdha në testet kognitive mund »të kamuflojnë belbëzimin e njëmendët« me forma të tjera, e jo me ato që konsiderohen manifestime të belbëzimit. Konstatimi i këtillë mund të lidhet me rezultatet e studimeve të autorëve të ndryshëm përkitazi me »tejkalimin« e vështirësive në të folur pa terapi të katër të pestat »të atyre që kanë belbëzuar« (Sheehan dhe Martin, 1966, 1970; Martin e Sheehan, 1968; sipas Sheehan, 1970). Natyrisht, ky konstatim nuk mund të pranohet pa studime e verifikime të mëtejme. Me siguri që në »përmirësimin« e të folurit ndikojnë edhe faktorë të tjerë, të cilët mund të jenë edhe shumë më të rëndësishëm se funksionet kognitive. Mund të supozohet që funksionet kognitive ndikojnë në fillimin e zbulimit të rrugëve për »vetëpërmirësim« të paqartësisë në të folur.

Në kuadër të këtij grupi të variablave lypset ndarë variablën KOHA e cila ka realizuar numrin më të madh të lidhjeve karakteristike me variablat kognitive. Kjo variabël jo vetëm që ka realizuar një të katërtën e numrit të përgjithshëm të koeficienteve të vlefshëm në matricën e ndërkorrelacionit, veçse ajo edhe numerikisht ka realizuar lidhje më të mëdha me variablat kognitive. Meqë disa autorë konsiderojnë (Van Riper, 1971; Brestovci, 1977, 1978; Schaltenbrand, 1975) që rregullimi kohor i koordinimeve simbolike të të folurit, ose kuptimit të fjalëve, është shkak i drejtpërdrejtë i belbëzimit, do të ishte interesant të shqyrtoheshin më hollësisht raportet e kohës së realizimit të sinjaleve të të folurit dhe funksioneve kognitive.

Grupi i dytë i variablave të belbëzimit, që ka pasur zero lidhmëri, ka të bëjë me përsëritjen e pjesëve të fjalëve (RROK) dhe zgjatjen e tingujve (ZGJAT) . Autorët që merren me problematikën e belbëzimit konsiderojnë që manifestime më të dukshme, e njëherësh edhe më të rënda, në të folurit e personave që belbëzojnë janë përsëritja e pjesëve të fjalëve dhe zgjatja e tingujve. Wingate (1964) konsideron që vështirësitë e tilla rëndom janë të shpeshta, mjaft të theksuara dhe kontrollohen vështirë. Mendime tejet të ngjashme për këto dukuri mund të gjenden edhe te Karlin (1965), Eisenson (1958), Van Riper (1954, në Adler, 1966), Van Riper (1971), Brutton e Shoemaker (1967), Brestovci (1977) etj

Tabela nr. 5.

NDËRKORRELACIONET E VARIABLAVE TË BELBËZIMIT
DHE VARIABLAVE KOGNITIVE

	VLERA	KOHA	RROK	ZGJAT	FJALA	FRAZA	NDËRF	PAUZA	RITMI
W₁	-.01	-.09	.01	.04	-.02	-.09	-.08	-.10	-.02
EVE	-.12	-.19	-.06	.04	-.10	-.05	-.18	-.15	-.13
EVD	-.23	-.28	-.16	-.03	-.23	-.24	-.27	-.16	-.16
EVS	-.13	-.25	-.12	.01	-.10	-.08	-.22	-.24	-.13
MP	-.28	-.28	-.17	-.10	-.26	-.09	-.28	-.23	-.31
B₁	-.13	-.12	-.06	.00	-.14	-.15	-.13	-.12	-.08
B₂	-.13	-.20	-.01	.02	-.08	-.08	-.23	-.21	-.25
B₃	-.10	-.12	-.05	-.05	-.04	.03	-.15	.18	-.01
B₄	-.15	-.16	-.14	-.07	-.09	.02	-.11	-.20	-.22
B₅	-.11	-.20	-.10	.05	-.10	.02	-.15	-.21	-.15
B₆	-.12	-.08	-.08	-.03	-.05	-.01	-.22	-.10	-.09

5.3.2 Raportet regresiste ndërmjet variablave të belbëzimit dhe variablave kognitive

Janë bërë nëntë analiza regresiste, sa variabla të belbëzimit ishin, të cilat paraqitnin variabla kriteri. Sistemin prediktor të variablave e paraqitnin 11 variablat kognitive. Asnjë korrelacion multiple statistikisht nuk është treguar i vlefshëm në nivelin prej 0.05. Për këtë arsye mund të konkludohet që sistemi i variablave kognitive nuk mund të parashohë variabilitetin e asnjë variable dedikuar matjes së belbëzimit, e kjo të mos jetë e rastësishme.

Duhet theksuar rezultatet e regresionit të variablave NDËRF dhe KOHA. Variabla NDËRF ka variabilitet të përbashkët me prediktorët në vlerë prej 16 %, gjë që i përgjigjet koeficientit të korrelacionit multiple prej (0.40) me probabilitet (.10). Meqë variabla NDËRF përmban informatat për ndërfitjet e ndryshme (të tingujve, rrokjeve, fjalëve, frazave etj.) në shprehjen e të folurit, na duket e logjikshme që përmbajtja e variablave do të duhej reduktuar vetëm në ndërfitjen e tingujve, rrokjeve dhe tingujve joshprehës, gjë që do të kontribuonte për definimin më të mirë të kësaj variable.

Variabla koha e emisionit të të folurit (KOHA) në këtë studim ka përmbajtur vetëm kohën e leximit. Me siguri përmbajtja e saj dukshëm më mirë do të ishte definuar, e njëherësh ajo edhe me mirë do të kishte dalluar subjektet, sikur të ishte rezultante e një varg masash të realizimit kohor të sinjaleve të të folurit. Këtu para se gjithash mendohet në matjen dhe kohën e shqiptimit të segmenteve më të vogla të të folurit, siç janë tingujt dhe rrokjet, përsëritja dhe zgjatja e të cilëve paraqet manifestimet më qenësore të belbëzimit.

6. ANALIZA DHE VERIFIKIMI I HIPOTEZAVE

Në këtë hulumtim janë shtruar dy hipoteza kërkimore . Në hipotezën e parë është thënë se “*Kampioni i subjekteve që belbëzojnë nuk dallon nga kampioni i subjekteve që nuk belbëzojnë në variablat e dedikuara për caktimin të aftësive kognitive*”. Rezultatet e mbledhura me 11 variabla nga hapësira kognitive në dy grupe të peseëmbëdhjetëvjeçarëve (që belbëzojnë dhe atyre me të folur të rrjedhshëm), janë analizuar me dy metoda statistikore : analiza kanonike veçuese (diskriminative) dhe analiza njëfaktoriale e varianses. Rezultatet e dalta nga këto dy analiza e konfirmojnë hipotezën e thurur se grupet nuk dallojnë në aftësitë kognitive (Tabela nr. 1).

Hipoteza e dytë ka patur në shënjestër raportet ndërmjet llojeve të “jorrjedhshmërive” në të folur dhe aftësive kognitive dhe kanë qenë përpiluar kështu: “*Nuk ekziston lidhja e rëndësishme ndërmjet variablave dedikuar për caktimin të belbëzimit dhe variablave kognitive*”.

Në bazë të rezultateve të nëntë manifestimeve të të folurit dhe njëmbëdhjetë variablave të hapsirës kognitive , është konstatuar (karelacionet bivariante sipas Pearsonit dhe korrelacioni i shumefishtë i analizës së regresit), se nuk ka raporte statistikisht të vlefshme në mes këtyre dy hapsirave, me çka është verifikuar hipoteza e dytë (Tabela nr 5).

7. PËRFUNDIM

Qëllim kryesor i këtij punimi ishte studimi i dallimeve ndërmjet subjekteve që belbëzojnë dhe atyre që nuk belbëzojnë në hapësirën e 11 variablave kognitive, si dhe përcaktimi i raporteve ndërmjet nëntë masave për caktimin e belbëzimit dhe 11 variablave kognitive.

Me zbatimin e analizës kanonike veçuese dhe të analizës njëfaktoriale të variansës

është konstatuar që ndërmjet grupit të subjekteve të cilët belbëzojnë dhe grupit të moshatarëve të tyre që nuk belbëzojnë, nuk ekziston dallim i vlefshëm në funksionet kognitive. Rezultatet diç më të ulëta në disa teste të inteligjencës me siguri janë të lidhura me karakteristikat e personalitetit të subjekteve që belbëzojnë. Rezultatet mund të shërbejnë edhe për interpretim dhe analizë të suksesit shkollor të diç me të dobët të nxënësve që belbëzojnë, e që është konstatuar në një varg studimesh të autorëve të jashtëm. Pra, shkakun për sukses të dobët në shkollë nuk duhet kërkuar në (pa) aftësitë intelektuale, veçse, para së gjithash, në karakteristikat e personalitetit të personave që belbëzojnë dhe në pamundësitë e shfrytëzimit normal të kodit verbal.

Raportet ndërmjet variablave të belbëzimit dhe variablave kognitive janë konstatuar me koeficientet bivariate të korrelacionit dhe me analizën regresiste, ku variablat e belbëzimit kanë paraqitur sistemin e variablave të kriterit, ndërsa variablat kognitive kanë bërë sistemin e prediktorëve.

Rezultatet e analizës regresiste kanë dëshmuar që asnjë korrelacion multiple nuk është i rëndësishëm në nivel prej 0.05. Analiza bivariate e lidhmërisë së çifteve të variablave ka dëshmuar disa lidhmëri negative ndërmjet këtyre dy grupeve të variablave. Variablat KOHA, NDËRF, PAUZA dhe RITMI kanë realizuar lidhmëri më të mëdha me variablat kognitive. Variabla e përsëritjes së pjesëve të fjalës (RROK) dhe zgjatja e tingujve (ZGJAT) kanë zero korrelacione me të gjitha variablat kognitive.

Meqenëse nuk janë konstatuar dallime ndërmjet subjekteve që belbëzojnë dhe subjekteve që nuk belbëzojnë në 11 variabla kognitive, si dhe nuk është vërejtur kovariabilitet i dukshëm ndërmjet variablave të belbëzimit dhe variablave kognitive, mund të përfundohej që »nuk është e sigurt se faktorët kognitivë do të ishin një nga shkaktarët e belbëzimit, ndonëse mund të jenë të pranishëm në zhvillimin e dukurive shoqëruese⁴, por mund të ndikojnë në 'vete evitimin' e manifestimeve të kësaj vështirësie në komunikim verbal tingullor.

Literatura

1. Adler, S.: *A clinician's guide to stuttering*. Springfield, Ill.: Charles C. Thomas, 1966.
2. Agnello, J. G.: Change: Potential qualities become actualities. Speech Foundation of America. Memphis, Tennessee, 1972.
3. Beech, H. R. and Fransella: *Research and experiment in stuttering*. London: Pergamon Press, 1968.
4. Bikov, K. M.: *Udžbenik fiziologije*. Medicinska knjiga, Beograd— Zagreb, 1965.
5. Brestovci, B.: *Definicija mucanja*. Defektologija, 1970, Vol. 6, br. 2, 17-23.
6. Brestovci, B., Marković, S. i Vuletić, D.: Govor djece u osnovnoj školi. Defektologija, 1972, Vol. 8, br. 2, 54 - 60.
7. Brestovci, B.: *Mucanje i slušanje vlastitog govora*. Defektologija, 1972, Vol. 8, br. 2, 23-41.
8. Brestovci, B.: *Predikacija jakosti mucanja I*. Defektologija, 1975, Vol. 11, br. 1, 38-52.
9. Brestovci, B.: *Diskriminativna analiza nekih antropometrijskih i motoričkih dimenzija mucavaca i nemucavaca*. Magistarski rad. Fakultet za fizičku kulturu, Zagreb, 1975, (i pabotuar).
10. Brestovci, B.: *Predikacija jakosti mucanja II*. Specijalna škola, 1976, br. 1-2, 11-21.
11. Brestovci, B. i Krznar, I.: *Multidimenzionalni pristup etiologiji mucanja*. Zbornik rado

⁴ Ljubeshiq, M. dhe Brestovci, B.: *Nderlidhjet e belbëzimit dhe statusit intelektual*. Defektologija, 1979, Vol. 15, nr. 1, 1 - 8.

- sa Simpozija o mucanju u Dubrovniku, 1977.
12. Brestovci, B.: *Neki verbalni i neverbalni aspekti ponašanja relevantni za definiciju mucanja. Zbornik radova sa Simpozijuma o mucanju u Dubrovniku, 1977.* (u štampi).
 13. Brestovci, B.: *Klasifikacija pogrešaka u govoru osoba koje mucaju.* Defektologija, 1977, Vol. 13, br. 2, 1-16.
 14. Brestovci, B.: *Neke relacije između mucanja, motorike i anksioznosti. Doktorska disertacija,* Fakultet za defektologiju, Zagreb, 1979.
 15. Brutten, E. J., and Shoemaker, D. J.: *The modification of stuttering.* Englewood Cliffs, N. J.: Prentice-Hall, Inc., 1967.
 16. Brutten, E. J.: and Shoemaker, D. J.: *A two-factor learning theory of stuttering.* In Travis, L (ed.): *Handbook of speech pathology and audiology.* New York: Appleton, 1971.
 17. Cherry, C.: *On human communication.* Second ed. The M.I.T. Press, 1971.
 18. Eisenson, J.: *A perseverative theory of stuttering.* In J. Eisenson, Ed., *Stuttering: A symposium.* New York; Harper and Row, 1958.
 19. Froeschels, E.: *Selected papers (1940-1964):* Amsterdam: North-Holland, 1964.
 20. Freund, H.: *Psychopathology and problems of stuttering.* Springfield, Ill.: Charles C Thomas, 1966.
 21. Freund, H.: *Self-improvement after unsuccessful treatment.* In: *To the stutterer.* Speech Foundation of America Publication No. 9, Memphis, Tennessee, 1972.
 22. Furlan, I.: *Jednominutni ispit glasnog čitanja.* Školska knjiga, Zagreb, 1963.
 23. Goldman-Eisler, F.: *Discussion and further comments.* U Lenneberg, E. H. (ed.): *New direction in the study of language.* The M.I.T. Press, 1964.
 24. Goldman-Eisler, F.: *The relationship between temporal aspects of speech.* Nė Salzinger, K., and Salzinger, S. (ed.): *Research in verbal behavior and some neurophysiological implication.* Academic Press, New York, 1967.
 25. Johnson, W.: *Stuttering in children and adults: Thirty years of research at the University of Iowa.* Minneapolis: University of Minnesota Press, 1955.
 26. Johnson, W.: *The six men and the stuttering.* Nė: Eisenson, J. (ed.): *Stuttering — A symposium.* Harper and Row, New York, 1958.
 27. Johnson, W. et al.: *The onset of stuttering: Research findings and implications.* Minneapolis, University of Minnesota Press, 1959.
 28. Johnson, W.: *Measurement of oral reading and speaking rate and disfluency of adult male and female stutterers and nonstutterers.* J. S. Hear. Dis., Monog. Suppl. No. 7, 1961, 1-20.
 29. Johnson, W., Darley, F. L., and Spriestersbach, D. C.: *Diagnostic methods in speech pathology.* Harper and Row, New York, 1963.
 30. Karlin, I., W. Karlin, B. David and L. Gurren: *Development and disorders of speech in childhood.* Charles C Thomas, Springfield, Illinois, 1965.
 31. Luria, A.: *The regulative function of speech in its development and dissolution.* Nė: Salzinger, K., and Salzinger, S. (ed.): *Research in verbal behavior and some neurophysiological implication.* Academic Press, New York, 1967.
 32. Ljubišić, M. i Brestovci, B.: *Povezanost mucanja i intelektualnog statusa.* Defektologija, 1979, Vol. 15, br. 1, 1 - 8.
 33. Minifie, F., and Cooker, H.: *A disfluency index.* J.Sp.Hear. Dis., 1964, Vol.7, 189-192.
 34. Momirović, K. i Kovačević, V.: *Evaluacija dijagnostičkih metoda.* Republički zavod za zapošljavanje, Zagreb, 1970.
 35. Sander, E. L.: *Reliability of the Iowa spech disfluency test.* J. Speech Hear. Dis., 1961, Monogr. Suppl., No. 7, 21-30.

36. Schaltenbrand, G.: *The effects on speech and language of stereo- tactical stimulation in thalamus and corpus callosum*. Brain and Language, 1975, Vol.2, 70-77.
37. Sheehan, J. G.: *Stuttering: Research and therapy*. Harper and Row, New York, 1970.
38. Trotter, W. D., and M. M. Lesch: *Personal experiences with a stutter-aid*. J. Speech Hear. Dis., 1967, Vol. 32, 270-272.
39. Van Riper, C.: *Speech correction: principles and practice* (4th ed.). Englewood Cliffs, N. J. Prentice-Hall, 1963.
40. Van Riper, C.: *The nature of stuttering*. Prentice-Hall, Inc., Englewood Cliffs, N. J., 1971.
41. Van Riper, C.: *Putting it together. Në To the stutterer*. Speech: Foundation of America, Memphis, Tennessee, 1972.
42. Vigotski, L. S.: *Mišljenje i govor*. Nolit, Beograd, 1977.
43. Williams, D., Wark, M., and Minifie, F.: *Ratings of stuttering by audio, visual and audiovisual cues*. J. Speech Hear. Res., 1963, No. 1, 91-100.
44. Wingate, M. E.: *A standard definition of stuttering*. J. Speech Hear. Dis., 1964, Vol. 29, 484-489.
45. Wingate, M. E.: *Stuttering adaption and learning: I. The relevance of*
46. Wischner, G. J.: *Stuttering behavior and learning*. J. Speech Hear. Dis., 1950, Vol. 15, 324-335.
47. Wischner, G. J.: *Experimental approach to expectancy and anxiety in stuttering behavior*. J. Speech Hear. Dis., 1952, Vol. 17, 139-154.
48. Young, M. A.: *Predicting ratings of severity of stuttering*. J. Speech Hear. Dis., 1961, Monogr. Supp. 7, 31-54.

Tabela nr. 2

NORMALIZIMI I REZULTATEVE TË VLERËSUESVE

REZULTATET E PROCESIT TË NORMALIZIMIT JANË SHËNUAR ME SHENJAT:

SCORE - KATEGORIA E PËRGJIGJES, F - FREKUENCA E PËRGJIGJES NË KATEGORI TË CAKTUAR, FC – FREKUENCA KUMULATIVE, FCR - FREKUENCA KUMULATIVE RELATIVE, FCT - FREKUENCA E PRITUR KUMULATIVE, D - NDRYSHIMI NDËRMJET FREKUENCËS RELATIVE TË FITUAR DHE TË PRITUR, T - VLERAT I NORMALIZUAR DHE I STANDARDIZUAR PËR ÇDO KATEGORI TË PËRGJIGJES.

Tabela nr. 2.1.

NORMALIZIMI I REZULTATEVE TË VLERËSUESVE

VLERË-SUESI	SCORE	F	FC	FCR	FCT	D	T-vlera
So1	1	21	21	.1966	.1377	.0586	-1.29
	2	27	48	.4486	.3689	.0797	-.46
	3	26	74	.6916	.6633	.0283	.18
	4	15	89	.8318	.8805	.0487	.71
	5	18	107	1.0000	.9734	.0266	1.38
So 2	1	23	23	.2150	.1495	.0655	-1.24
	2	33	56	.5234	.3907	.1327	-.34
	3	20	76	.7103	.6856	.0247	.30
	4	15	91	.8505	.8933	.0429	.77
	5	16	107	1.0000	.9775	.0225	1.44
So 3	1	21	21	.1963	.1460	.0502	-1.29

	2	24	45	.4206	.4023	.0182	- .50
	3	34	79	.7383	.7119	.0264	.20
	4	16	95	.8879	.9139	-.0261	.89
	5	12	107	1.0000	.9851	.0149	1.59
So 4	1	18	18	.1682	.1279	.0403	-1.38
	2	31	49	.4579	.3744	.0835	- .49
	3	23	72	.6729	.6901	-.0172	.16
	4	22	94	.8785	.9053	-.0268	.78
	5	13	107	1.0000	.9834	.0166	1.55
So 5	1	24	24	.2243	.1524	.0719	-1.22
	2	29	53	.4953	.3873	.1080	- .36
	3	20	73	.6822	.6750	.0073	.22
	4	16	89	.8318	.8837	-.0519	.70
	5	18	107	1.0000	.9734	.0266	1.38
So 6	1	32	32	.2991	.1961	.1029	-1.06
	2	29	61	.5701	.4525	.1176	- .16
	3	15	76	.7103	.7314	-.0211	.36
	4	17	93	.8693	.9120	-.0429	.80
	5	14	107	1.0000	.9817	.0183	1.51
So 7	1	27	27	.2523	.1727	.0796	-1.15
	2	30	57	.5327	.4258	.1069	- .27
	3	20	77	.7196	.7154	.0042	.32
	4	16	93	.8692	.9075	-.0384	.82
	5	14	107	1.0000	.9815	.0187	1.51
So 8	1	26	26	.2430	.1638	.0792	-1.17
	2	25	51	.4766	.4042	.0724	- .36
	3	25	76	.7103	.6894	.0209	.24
	4	14	90	.8411	.8908	-.0496	.76
	5	17	107	1.0000	.9754	.0246	1.41
So 9	1	24	24	.2243	.1585	.0658	-1.21
	2	26	50	.4673	.4089	.0584	- .40
	3	24	74	.6916	.7053	-.0137	.20
	4	19	93	.8692	.9048	-.0357	.77
	5	14	107	1.0000	.9812	.0188	1.51
So 10	1	30	30	.2804	.1810	.0994	-1.08
	2	25	55	.5140	.4209	.0931	- .26
	3	21	76	.7103	.6958	.0145	.29
	4	13	89	.8318	.8896	-.0578	.74
	5	18	107	1.0000	.9736	.0264	1.38

Tabela nr. 2.2.

NDËRKORRELACIONET E VLERËSUESVE

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1.000	.807	.721	.776	.819	.812	.840	.856	.780	.829
2		1.000	.785	.759	.825	.769	.718	.790	.733	.786
3			1.000	.760	.793	.780	.790	.746	.739	.807
4				1.000	.790	.814	.813	.837	.875	.797
5					1.000	.790	.813	.839	.788	.809
6						1.000	.866	.838	.812	.859
7							1.000	.874	.841	.861
8								1.000	.843	.838
9									1.000	.805
10										1.000

Tabela nr. 2.3.

UNIKUITETI	($dg^{-1} R^{-1}$)
1.	.1760
2.	.2325
3.	.2323
4.	.1792
5.	.1968
6.	.1790
7.	.1389
8.	.1392
9.	.1742
10.	.1733

Tabela nr. 2.4.

RRËNJËT KARAKTERISTIKE

Numri	Lambda	Kumulativisht
1.	8.2889	.8289 x
2.	.3759	.8665
3.	.2565	.9021
4.	.2412	.9162
5.	.1934	.9356
6.	.1697	.9526
7.	.1391	.9665
8.	.1306	.9795
9.	.1112	.9907
10.	.0929	1.0000

Tabela nr. 2.5.

PROJEKSIONET NË KOMONENTIN E PARË	
1.	.9162
2.	.8854
3.	.8801
4.	.9034
5.	.9088
6.	.8165
7.	.9365
8.	.9302
9.	.9026
10.	.9226

Tabela nr. 2.6.

KOMUNALITETI ($h^2 - dgHH'$)	
1.	.8394
2.	.7839
3.	.7745
4.	.8161
5.	.8259
6.	.8400
7.	.8770
8.	.8653
9.	.8147

10.	.8501
-----	-------

Tabela nr. 2.7.

DISTRIBUIMI I REZULTATEVE TË KOMPONENTIT TË PARË KRYESOR
(INTENSITETI I BELBËZIMIT)

XA = .0000 SIG 2 = 1.0000 MIN = - 1.4237
DX = .1895 SIG = 1.0000 MAX = 1.81150

Distribuími

Kla- sat	Kufijtë	F	FC	FCR	FCT	D
1.	- -1.02	19	19	.1776	.1541	.0234
2.	- 1.02 - - .21	30	49	.4579	.4171	.0408
3.	.21 - .60	27	76	.7103	.7259	-.0156
4.	.60 - 1.41	17	93	.8692	.9208	-.0516
5.	1.41 -	14	107	1.0000	.9868	.0132

TEST = .1576
MAX D = .0516

Tabela nr. 3.1.

TREGUESIT THEMELORË STATISTIKORË TË VARIABLAVE
TË GABIMEVE NË TË FOLUR

	XA	DX	SIG	MIN	MAX	TEST	MAX-D
1. RROK	14.78	2.93	15.83	0.0	52	.1576	.1493
2. FJALA	7.34	1.74	9.14	0.0	30	.1576	.1387
3. FRAZA	4.68	.82	18.55	0.0	20	.1576	.1050
4. ZGJAT	6.04	1.66	8.75	0.0	30	.1576	.2386
5. NDËRF	17.02	3.78	19.96	0.0	60	.1576	.1786
6. PAUZA	13.44	2.98	15.75	0.0	60	.1576	.1796
7. TEMPO	3.32	.85	4.50	0.0	15	.1576	.1399
8. RITMI	19.72	3.27	17.28	0.0	50	.1576	.1299
9. ELID	6.46	1.14	6.03	0.0	41	.1576	.1388

Tabela nr. 3.3.

MATRICA E NDËRKORRELACIONEVE TË VARIABLAVE TË GABIMEVE NË TË FOLUR DHE
KOEFCIENTET E DETERMINIMIT NË DIAGONALE

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
1. RROK	(.66)	.67	.44	.64	.56	.61	.03	.33	.16
2. FJALA		(.67)	.48	.43	.74	.63	.15	.34	.19
3. FRAZA			(.35)	.22	.40	.19	.22	-.00	.19
4. ZGJAT				(.50)	.40	.54	.13	.26	.02
5. NDËRF					(.62)	.65	.16	.33	.18
6. PAUZA						(.65)	-.07	.51	.07
7. TEMPO							(.24)	.07	.29
8. RITMI								(.30)	.07
9. ELID									(.14)